



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	24. 12. 2020	0	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinita Org /Unit	Pr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM8HCK	3306/2020		113

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 369/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.369/2020 të datës 20.11.2020, të parashtruar nga [REDACTED], me adresë banimi rruga „Jozef Biden” fshati Livoç i Ultë, Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “ Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr. 369/2020 e datës 20.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

[REDACTED], me datë 20.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore se ankuesi ka plotësuar kushtet ligjore për deklarimin e statusit të nëpunësit civil, sipas nenit 83 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 27.11.2020, ka dërguar tek Ministria e Infrastrukturës kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2794/2020, ndërsa me datën 04.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2947/2020 se bashku më shkresat e lëndës.

Kolegji për vërtetim i plotë dhe drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën A nr.369/2020, e datës 20.11.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.11.2020; Vërtetim i Marrëdhënies së Punës i datës 24.09.2020; Referencë e datës 01.08.2019; Referencë e datës 11.06.2018; Letër Referencë e datës 12.01.2018; Referencë e datës 31.01.2019; Kërkesë e datës 24.09.2020; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.08.2016; Marrëveshje

për Shërbime të Veçanta e datës 06.09.2016; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.03.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.06.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 04.09.2017; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.02.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.05.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 01.08.2018; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 14.03.2019; Pliko e datës 08.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 04.12.2020; e-mail nga [REDACTED] për [REDACTED] R. [REDACTED] e datës 12.04.2018; Listë Distribuimi e datës 19.06.2018; Letër Referencë e datës 23.03.2018; Kërkesë për informata zyrtare e datës 24.12.2020; Njoftim lidhur me kërkesën për informata zyrtare e datës 24.12.2020;

Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave, pasi ka shtjelluar dhe shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës, në kuptim të pranueshmërisë së saj, siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 83 paragrafi 17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore, që ti njihet statusi i nëpunësit civil sipas nenit 83 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publik .

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi pa ndonjë procedurë të thjeshtësuar, ka krijuar marrëdhënie kontraktuale (si ofrues i shërbimeve) me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit (si porosites i shërbimeve), për kryerje të shërbimeve të veçanta nga fusha e detyrave dhe përgjegjësisve të Zyrtarit Administrativ në Njësinë e Patente Shoferit, në Gjilan. Fillimisht, ankuesi ka lidh marrëveshjen për shërbime të veçanta me datë 01.08.2016, në kohëzgjatje nga 02.05.2016 deri 30.10.2018, pastaj ka vazhduar me tej me marrëveshje tjera për shërbime të veçanta po në kohëzgjatje prej 6 muajsh. pa ndonjë proces rekrutimi. Marrëveshja e fundit për shërbime të veçanta është lidhur me datë 14.03.2019 për periudhën nga 01.02.2019 deri 31.07.2019.

Sipas ankesës, ankuesi i është drejtuar me datë 24.09.2020, Ministrisë së Infrastrukturës më kërkesë për krijimin e marrëdhënies së punës, e për të cilën nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

Ligji për Zyrtarët Publikë përkatësisht neni 83 paragrafi 2 ka përcaktuar "2. Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mbanë një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji ;2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë". Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji vlerëson se për deklaram të statusit të nëpunësit civil të një nëpunësi i cili nuk ka statusin e Shërbyesit Civil sipas Ligjit të shfuqizuar për Shërbimin Civil Nr.03/L-149, kërkohet që nëpunësi në fjalë të ketë krijuar një marrëdhënia pune sipas një akti të rregullt juridik respektivisht të ketë krijuar marrëdhënie pune të karakterit juridiko-administrativ, pozita e të cilit për nga detyrat dhe përgjegjësitë bazuar në Ligjin për Zyrtares Publikë konsiderohet pozitë e shërbimit civil, marrëdhënia e punës të jetë krijuar se paku dy vjet para datës se hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë si dhe të jenë plotësuar kushtet e

përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me nenin 8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh " Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji. 2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 2.2. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji" si dhe nëpunësi duhet të ketë rezultate të mira në punës se paku për dy vitet e fundit. Andaj, mbështetur në këtë konstatim si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankuesi nuk ka krijuar një marrëdhënie juridike-administrative me Ministrinë e Infrastrukturës, por një marrëdhënie kontraktuale më qëllim të kryerjes së shërbimeve të caktuara për një periudhë të caktuar kohore, ashtu siç parashihej me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit të shfuqizuar Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku thuhet "Emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit".


Po ashtu, bazuar në nenin 84 paragrafi 1 të Ligjit NR. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se marrëveshjet për shërbime të veçanta të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jenë të vlefshme vetëm deri në aftin e përcaktuar në këto marrëveshje ku citojmë se "Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik." Andaj, nga kjo rrjedhë se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe konstatimit të bazës juridike si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda numër. A. Nr. 369/2020


Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; 
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMShCK-së .

